



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 37/2018(JR)
Nr. 37/2 Prot.

Tiranë, më 25.06.2019

SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces si dhe të gjithë personat e interesuar, se ditën **e martë**, në datën **16.07.2019**, ora **10:00**, do të gjykohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh çështja me numër regjistri 37/2018 (JR), datë 04.12.2018, për ankimin që subjekti i rivlerësimit Dritan Rreshka ka bërë kundër vendimit nr. 55, datë 31.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykses, përbëhet nga gjyqtarët:

| | |
|----------------------------------|------------------------|
| Kryesues i Trupit Gjykses | Albana Shtylla |
| Relatore e Çështjes | Ina Rama |
| Gjyqtar | Ardian Hajdari |
| Gjyqtar | Sokol Çomo |
| Gjyqtare | Rezarta Schuetz |

Bazuar në nenin 49, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.

Bazuar në nenin 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe me njoftim individual të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

KRYESUESI I TRUPIT GJYKUES
GJYQTARE
Albana SHTYLLA

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 3, Tiranë, www.kpa.al, e-mail: info@kpa.al

